



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 495/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovë (PDAK) , për shkak të kërcënimit gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me nr. A-495, A-496, dhe A-497, të datës 13.12.2010, të subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovë (PDAK) .

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar 3 (tre) ankesa, me numër A-495, A-496, dhe A-497 paraqitur nga PAI kundër subjektit politik PDAK në të cilat pretendohet se :

Simpatizantë e PDAK-së nën dirigjimin e kryetarit të tyre Danush Ademi, kanë organizuar militant të PDAK-së duke kërcënuar votuesit të futen në vetura dhe të dërgohen në QV në komunën e Ferizajt. Këto sjellje kanë fiksuar votuesit të cilët janë detyruar të futen në vetura për të votuar për PDAK-në.

Militantët e PDAK-së, kanë sulmuar qytetarët e komunitetit ashkali duke përdorur dhunë ndaj tyre si dhe duke kërcënuar në forma të ndryshme persona të lagjes 29 në Fushë Kosovë për të votuar për subjektin politik PDAK.

Po ashtu në ditën e zgjedhjeve militantë e PDAK-së në rrugën “Enver Topalli” në lagjen “Sallahane” e banuar me komunitet ashkali kanë organizuar grupe të ndjeshme të cilët kanë njohur vetëm gjuhën e forcës për të bërë trysni për të votuar për PDAK

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qëllim të lehtësimit të shyrimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që përmbajne ne vete çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoj të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik PAI, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur kërcënim gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 495/2010 më datën 15.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

